

|  |          |
|--|----------|
| REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /<br>REPUBLIC OF KOSOVO         |          |
| QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT   |          |
| MINISTRIA E EKONOMISE<br>MINISTARSTVO EKONOMIJE<br>MINISTRY OF ECONOMY |          |
| Njësia Org.<br>Org. Jedin<br>Org. Unit                                 | 01/3     |
| Nr. i faqesve<br>Broj strana<br>No. pages                              | 1        |
| Nr. Prof.<br>Br. Prof.<br>Prof.No.                                     | 584-1    |
| Datum.<br>Date:  | 03.04.26 |
| PRISHTINE/A  | NO.1     |

|   |             |
|---|-------------|
| KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT<br>REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNAPDEVANJE |             |
| »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.   |             |
| Nr.   | 2092        |
| Dt.   | 31.03. 2026 |
| PRIZREN   |             |

# RAPORT

**Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve në  
zonën e shërbimit për periudhën Janar-Dhjetor 2025  
në zonën e shërbimit të cilën e mbulon K.R.U  
“Hidroregjioni Jugor” SH.A.**

**Mars, 2026**

**Titulli i projektit: Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve në zonën e shërbimit për periudhen Janar-Dhjetor 2026 në zonën e shërbimit të cilen e mbulon K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.**

**OPERATORI EKONOMIK:**



Business Support Center  
**D&D Business Support Center**

Rr. Xheladin Hana, Iliria Building,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564  
E-mail: [info@dd-bsc.com](mailto:info@dd-bsc.com)  
Web: [www.dd-bsc.com](http://www.dd-bsc.com)

**AUTORITETI  
KONTRAKUES:**



KOMPANIA RAJONALE E UJËSIELLËSIT SH.A  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNAPDEVANJE D.D

**HIDROREGJIONI JUGOR**

**K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH. A**  
Rr. Wesley Clark p.n, 20000 Prizren  
Tel: +381 (0) 29 222 631  
Web: [www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)

## TABELA E PËRMBAJTJES

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. HYRJE</b> .....   | <b>9</b>  |
| <b>2. PROCESI I REALIZIMIT TË HULUMTIMIT</b> .....  | <b>10</b> |
| <b>3. ANALIZA E TË DHËNAVE</b> .....  | <b>11</b> |
| 3.1. Struktura e mostrës sipas komunave dhe kategorive .....  | 11        |
| 3.2. Zona e Shërbimit .....   | 12        |
| 3.3. Kënaqshmëria me ujë të pijes .....   | 13        |
| 3.4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhblokime të kanalizimeve .....  | 14        |
| 3.5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit.....  | 15        |
| 3.6. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave .....                         | 16        |
| 3.7. Vlerësimi i mundësive të pagesave së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza.....   | 17        |
| 3.8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara .....   | 18        |
| 3.9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera.....   | 19        |
| 3.10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit .....   | 20        |
| 3.11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit.....   | 21        |
| 3.12. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit.....  | 22        |
| 3.13. Ujërat e ndotura dhe Kanalizimet .....  | 23        |
| <b>4. SEKTORI I AMVISËRISË</b> .....  | <b>24</b> |
| 4.1. Zona e shërbimit në sektorin e amvisërisë.....   | 24        |
| 4.2. Kënaqshmëria me ujë të pijës në sektorin e amvisërisë .....  | 25        |
| 4.3. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhblokime të kanalizimeve në sektorin e amvisërisë .....   | 26        |
| 4.4. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e amvisërisë.....   | 27        |
| 4.5. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e amvisërisë..... | 28        |
| 4.6. Vlerësimi i mundësive të pagesave së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e amvisërisë .....   | 29        |
| 4.7. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e amvisërisë.....   | 30        |
| 4.8. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e amvisërisë.....  | 31        |

|  |           |
|--|-----------|
| 4.9. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë .....  | 32        |
| 4.10. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë.....   | 33        |
| 4.11. Arsytet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë.....   | 34        |
| 4.12. Ujërat e ndotura dhe Kanalizimet në sektorin e amvisërisë .....  | 35        |
| <b>5. SEKTORI I BIZNESEVE .....</b>  | <b>36</b> |
| 5.1. Zona e shërbimit në sektorin e bizneseve.....   | 36        |
| 5.2. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e bizneseve.....   | 37        |
| 5.3. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllokime të kanalizimeve në sektorin e bizneseve.....   | 38        |
| 5.4. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e bizneseve .....  | 39        |
| 5.5. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e bizneseve .....      | 40        |
| 5.6. Vlerësimi i mundësive të pagesave së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e bizneseve.....  | 41        |
| 5.7. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e bizneseve .....  | 42        |
| 5.8. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e bizneseve .....   | 43        |
| 5.9. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve.....  | 44        |
| 5.10. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve .....   | 45        |
| 5.11. Arsytet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve .....   | 46        |
| 5.12. Ujërat e ndotura dhe Kanalizimet në sektorin e bizneseve.....  | 47        |
| <b>6. SEKTORI I INSTITUCIONEVE .....</b>   | <b>48</b> |
| 6.1. Zona e shërbimit.....   | 48        |
| 6.2. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e institucioneve.....  | 49        |
| 6.3. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllokime të kanalizimeve në sektorin e institucioneve.....  | 50        |
| 6.4. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e institucioneve .....   | 51        |
| 6.5. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e institucioneve ..... | 52        |

|  |           |
|--|-----------|
| 6.6. Vlerësimi i mundësive të pagesave së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e institucioneve.....                       | 53        |
| 6.7. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e institucioneve.....                                      | 54        |
| 6.8. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e institucioneve.....                                 | 55        |
| 6.9. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve..... | 56        |
| 6.10. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve  | 57        |
| 6.11. Arsytet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve.....                             | 58        |
| 6.12. Ujërat e ndotura dhe Kanalizimet në sektorin e institucioneve.....   | 59        |
| <b>7. KOMENTET NGA PYETJA E 12 E PYETËSORIT .....</b>  | <b>60</b> |
| <b>8. REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE .....</b>  | <b>61</b> |
| <b>9. ANNEX 1. PYETESORI .....</b>   | <b>62</b> |

## LISTA E TABELAVE

|  |    |
|--|----|
| Tabela 1. Lloji i konsumatorit .....   | 11 |
| Tabela 2. Zona e Shërbimit.....  | 12 |
| Tabela 3. Kënaqshmëria me ujë të pijes .....   | 13 |
| Tabela 4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllkime të kanalizimeve.....   | 14 |
| Tabela 5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit.....  | 15 |
| Tabela 6. Nivelit i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave.....                           | 16 |
| Tabela 7. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza.....   | 17 |
| Tabela 8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara .....   | 18 |
| Tabela 9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera.....   | 19 |
| Tabela 10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit .....   | 20 |
| Tabela 11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit .....  | 21 |
| Tabela 12. Arsytet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit.....   | 22 |
| Tabela 13. Ku shkojnë ujërat e ndotura .....   | 23 |
| Tabela 14. Zona e Shërbimit në sektorin e amvisërisë.....  | 24 |
| Tabela 15. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm në sektorin e amvisërisë .....   | 25 |
| Tabela 16. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllkime të kanalizimeve në sektorin e amvisërisë .....  | 26 |
| Tabela 17. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e amvisërisë .....   | 27 |
| Tabela 18. Nivelit i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e amvisërisë..... | 28 |
| Tabela 19. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e amvisërisë .....  | 29 |
| Tabela 20. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e amvisërisë .   | 30 |
| Tabela 21. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e amvisërisë  | 31 |

|  |    |
|--|----|
| Tabela 22. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë .....  | 32 |
| Tabela 23. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë .....   | 33 |
| Tabela 24. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë  | 34 |
| Tabela 25. Ku shkojnë ujerat e ndotura në sektorin e amvisërisë .....  | 35 |
| Tabela 26. Zona e shërbimit në sektorin e bizneseve .....  | 36 |
| Tabela 27. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e bizneseve.....   | 37 |
| Tabela 28. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllkime të kanalizimeve në sektorin e bizneseve.....  | 38 |
| Tabela 29. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e bizneseve.....   | 39 |
| Tabela 30. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e bizneseve .....      | 40 |
| Tabela 31. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e bizneseve.....  | 41 |
| Tabela 32. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e bizneseve ...  | 42 |
| Tabela 33. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e bizneseve .   | 43 |
| Tabela 34. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve.....  | 44 |
| Tabela 35. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve.....   | 45 |
| Tabela 36. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve   | 46 |
| Tabela 37. Ku shkojnë ujerat e ndotura në sektorin e bizneseve .....   | 47 |
| Tabela 38. Zona e Shërbimit në sektorin e institucioneve .....   | 48 |
| Tabela 39. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e institucioneve .....   | 49 |
| Tabela 40. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllkime të kanalizimeve në sektorin e institucioneve.....   | 50 |
| Tabela 41. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e institucioneve.....  | 51 |
| Tabela 42. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e institucioneve ..... | 52 |
| Tabela 43. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e institucioneve.....   | 53 |
| Tabela 44. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e institucioneve .....   | 54 |
| Tabela 45. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e institucioneve .....  | 55 |
| Tabela 46. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve.....   | 56 |
| Tabela 47. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve.....  | 57 |
| Tabela 48. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve.....   | 58 |
| Tabela 49. Ku shkojnë ujëret e ndotura në sektorin e institucioneve.....   | 59 |

## LISTA E FIGURAVE

|   |    |
|---|----|
| Figura 1. Lloji i konsumatorit.....   | 11 |
| Figura 2. Zona e Shërbimit .....  | 12 |
| Figura 3. Kënaqshmëria me ujë të pijes .....  | 13 |
| Figura 4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllokime të kanalizimeve.....   | 14 |
| Figura 5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit .....  | 15 |
| Figura 6. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave.....                           | 16 |
| Figura 7. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza .....   | 17 |
| Figura 8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara.....   | 18 |
| Figura 9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera.....  | 19 |
| Figura 10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit .....  | 20 |
| Figura 11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit .....   | 21 |
| Figura 12. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit .....  | 22 |
| Figura 13. Ku shkojnë ujërat e ndotura.....   | 23 |
| Figura 14. Zona e Shërbimit sektorin e amvisërisë .....   | 24 |
| Figura 15. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm në sektorin e amvisërisë.....   | 25 |
| Figura 16. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllokime të kanalizimeve në sektorin e amvisërisë .....  | 26 |
| Figura 17. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e amvisërisë .....  | 27 |
| Figura 18. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e amvisërisë..... | 28 |
| Figura 19. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e amvisërisë .....   | 29 |
| Figura 20. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e amvisërisë...   | 30 |
| Figura 21. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e amvisërisë.  | 31 |
| Figura 22. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë .....   | 32 |
| Figura 23. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e amvisërisë.....   | 33 |
| Figura 24. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit .....  | 34 |
| Figura 25. Ku shkojnë ujërat e ndotura në sektorin e amvisërisë.....  | 35 |
| Figura 26. Zona e shërbimit në sektorin e bizneseve .....   | 36 |
| Figura 27. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e bizneseve .....   | 37 |
| Figura 28. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllokime të kanalizimeve në sektorin e bizneseve.....  | 38 |
| Figura 29. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e bizneseve.....  | 39 |
| Figura 30. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e bizneseve.....  | 40 |
| Figura 31. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e bizneseve.....   | 41 |
| Figura 32. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e bizneseve....   | 42 |
| Figura 33. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e bizneseve..  | 43 |
| Figura 34. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve.....   | 44 |

**Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve në zonën e shërbimit për periudhën Janar-Dhjetor 2026 në zonën e shërbimit të cilen e mbulon K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**

---

|  |    |
|--|----|
| Figura 35. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve .....  | 45 |
| Figura 36. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e bizneseve. 46   |    |
| Figura 37. Ku shkojnë ujërat e ndotura në sektorin e bizneseve .....   | 47 |
| Figura 38. Zona e Shërbimit në sektorin e institucioneve .....   | 48 |
| Figura 39. Kënaqshmëria me ujë të pijes në sektorin e institucioneve.....  | 49 |
| Figura 40. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhbllkime të kanalizimeve në sektorin e institucioneve.....   | 50 |
| Figura 41. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit në sektorin e institucioneve.....  | 51 |
| Figura 42. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave në sektorin e institucioneve ..... | 52 |
| Figura 43. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në sektorin e institucioneve .....  | 53 |
| Figura 44. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara në sektorin e institucioneve   | 54 |
| Figura 45. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera në sektorin e institucioneve .....  | 55 |
| Figura 46. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve .....  | 56 |
| Figura 47. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve .....   | 57 |
| Figura 48. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit në sektorin e institucioneve .....  | 58 |
| Figura 49. Ku shkojnë ujërat e ndotura në sektorin e institucioneve .....  | 59 |

## 1. HYRJE

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. ka një rol thelbësor në ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për një numër të madh qytetarësh në rajon. Kompania është e fokusuar në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë të pijshëm, duke vendosur në qendër standardet profesionale dhe përgjegjësinë ndaj komunitetit.

Ky angazhim reflektohet në investimet e vazhdueshme në infrastrukturë, modernizimin e rrjetit dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, me synimin për të garantuar cilësi më të lartë dhe besueshmëri më të madhe për konsumatorët.

Për periudhën Janar–Dhjetor 2025 është realizuar një hulumtim për të matur nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve dhe për të evidentuar fushat ku mund të ndërhyhet për përmirësim. Studimi është zhvilluar nga D&D Business Support Center dhe është financuar nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A., me qëllim mbledhjen e vlerësimeve dhe përvojave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Kompania operon në katër komuna kryesore: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Hulumtimi është strukturuar në tri pjesë themelore. Pjesa e parë paraqet qëllimin dhe objektivat, duke sqaruar synimin për matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve dhe identifikimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm. Pjesa e dytë përshkruan metodologjinë e përdorur, përfshirë instrumentet e mbledhjes së të dhënave dhe analizën statistikore të rezultateve. Pjesa e tretë përmbledh gjetjet kryesore dhe ofron rekomandime konkrete për rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e komunikimit dhe forcimin e performancës operacionale.

Përmes këtij hulumtimi synohet të ofrohet një pasqyrë e qartë mbi perceptimet e konsumatorëve dhe nivelin e kënaqshmërisë së tyre. Rezultatet shërbejnë si bazë për vendimmarrje dhe për hapa të mëtejshëm drejt përmirësimit të furnizimit me ujë, mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimit dhe rritjes së efikasitetit të përgjithshëm të kompanisë.

## 2. PROCESI I REALIZIMIT TË HULUMTIMIT

Hulumtimi është zhvilluar me qëllim mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore mbi nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve ndaj shërbimeve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes një pyetësoi të strukturuar, i cili ka mundësuar matjen e perceptimeve të respondentëve dhe identifikimin e fushave ku kërkohen përmirësime.

Të dhënat janë siguruar përmes disa kanaleve, përfshirë platformën elektronike Google Forms, intervista telefonike, publikime në rrjete sociale dhe anketim fizik në terren në komunat që mbulohen nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A.

Instrumenti i hulumtimit përmban 12 pyetje dhe ka përfshirë 3,190 respondentë nga rajoni i Prizrenit, konkretisht nga komunat Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash. Përzgjedhja është bërë duke synuar përfaqësim të balancuar gjeografik, demografik, social dhe sektorial.

Struktura e pyetësoi është ndarë në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë përfshin të dhëna të përgjithshme mbi profilin e respondentëve, si vendbanimi, zona e shërbimit dhe kategoria përkatëse, amvisëri, biznes apo institucion. Pjesa e dytë fokusohet në vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga K.R.U., përfshirë cilësinë e furnizimit me ujë, menaxhimin e ujërave të zeza, trajtimin e ankesave dhe kërkesave, strukturën tarifore si dhe nivelin e informimit për ndërprerjet dhe mirëmbajtjen e rrjetit.

Ky proces metodologjik ka shërbyer si bazë për një vlerësim të strukturuar dhe të besueshëm të performancës së shërbimeve. Rezultatet do të përdoren për planifikim më të saktë dhe për ndërhyrje konkrete në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit. Hulumtimi i referohet periudhës Janar–Dhjetor 2025.

### 3. ANALIZA E TË DHËNAVE

#### 3.1. Struktura e mostrës sipas komunave dhe kategorive

Hulumtimi ka përfshirë anketimin e amvisërive, bizneseve dhe institucioneve brenda zonave që mbulohen nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A.


Mbledhja e të dhënave është realizuar në komunat Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash, duke përfshirë tri kategori kryesore respondentësh: amvisëri, biznese dhe institucione. Nga gjithsej 3,190 pjesëmarrës, 2,280 ose 71.47% i takojnë kategorisë së amvisërive, 625 ose 19.59% përfaqësojnë bizneset, ndërsa 285 ose 8.93% janë institucione.

Struktura e detajuar e shpërndarjes sipas komunave dhe kategorive paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim.

Tabela 1. Lloji i konsumatorit

| Qytet     | Amviseri | Biznese | Institucione | Totali  |
|-----------|----------|---------|--------------|---------|
| Prizren   | 1450     | 460     | 190          | 2100    |
|           | 69.05%   | 21.90%  | 9.05%        | 65.83%  |
| Suharekë  | 360      | 70      | 40           | 470     |
|           | 76.60%   | 14.89%  | 8.51%        | 14.73%  |
| Malishevë | 290      | 70      | 40           | 400     |
|           | 72.50%   | 17.50%  | 10.00%       | 12.54%  |
| Dragash   | 180      | 25      | 15           | 220     |
|           | 81.82%   | 11.36%  | 6.82%        | 6.90%   |
| Total     | 2280     | 625     | 285          | 3190    |
|           | 71.47%   | 19.59%  | 8.93%        | 100.00% |

Figura 1. Lloji i konsumatorit




### 3.2. Zona e Shërbimit

Zona e shërbimit paraqet shpërndarjen e respondentëve në komunat që mbulohe nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A., konkretisht në Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash, duke analizuar ndarjen mes zonave urbane dhe rurale. Nga gjithsej 3,190 të anketuar, 1,918 ose 60.13% jetojnë në zona urbane, ndërsa 1,272 ose 39.87% në zona rurale. Pjesa më e madhe e respondentëve është nga Prizreni, ku 1,272 (60.57%) janë nga zona urbane dhe 828 (39.43%) nga zona rurale. Në Suharekë, 303 (64.47%) i përkasin zonës urbane dhe 167 (35.53%) zonës rurale. Në Malishevë, 227 (56.75%) janë urbanë dhe 173 (43.25%) ruralë. Në nivel rajonal, Dragashi përfaqëson 6.90% të mostrës totale, ku 6.05% i takojnë zonës urbane dhe 8.18% zonës rurale në raport me totalin përkatës.. Këto të dhëna tregojnë një dominim të lehtë të respondentëve nga zonat urbane në nivel rajonal, ndërsa në disa komuna raporti mes zonës urbane dhe rurale mbetet relativisht i afërt.

Tabela 2. Zona e Shërbimit

| Qytet     | Urban  | Rural  | Totali  |
|-----------|--------|--------|---------|
| Prizren   | 1272   | 828    | 2100    |
|           | 60.57% | 39.43% | 65.83%  |
| Suharekë  | 303    | 167    | 470     |
|           | 64.47% | 35.53% | 14.73%  |
| Malishevë | 227    | 173    | 400     |
|           | 56.75% | 43.25% | 12.54%  |
| Dragash   | 116    | 104    | 220     |
|           | 6.05%  | 8.18%  | 6.90%   |
| Total     | 1918   | 1272   | 3190    |
|           | 60.13% | 39.87% | 100.00% |

Figura 2. Zona e Shërbimit



### 3.3. Kënaqshmëria me ujë të pijes

Këto të dhëna paraqesin nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me furnizimin me ujë të pijshëm në komunat e mbuluara nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A., bazuar në 3,190 respondentë.


Në nivel rajonal, 1,743 respondentë ose 54.64% janë shprehur shumë të kënaqur, 887 ose 27.81% të kënaqur, 448 ose 14.04% deri diku të kënaqur dhe 112 ose 3.51% të pakënaqur. Në total, 2,630 persona ose 82.45% e vlerësojnë pozitivisht shërbimin (shumë të kënaqur dhe të kënaqur).

Sipas komunave, në Prizren 56.10% janë shumë të kënaqur, në Suharekë 52.55%, në Malishevë 50.25% dhe në Dragash 53.18%. Në të gjitha komunat vihet re dominim i vlerësimit pozitiv, ndërsa niveli i pakënaqshmërisë mbetet i ulët.

Tabela 3. Kënaqshmëria me ujë të pijes

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1178              | 507         | 336                   | 79            | 2100    |
|           | 56.10%            | 24.14%      | 16.00%                | 3.76%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 247               | 155         | 55                    | 13            | 470     |
|           | 52.55%            | 32.98%      | 11.70%                | 2.77%         | 14.73%  |
| Malishevë | 201               | 137         | 48                    | 14            | 400     |
|           | 50.25%            | 34.25%      | 12.00%                | 3.50%         | 12.54%  |
| Dragash   | 117               | 88          | 9                     | 6             | 220     |
|           | 53.18%            | 40.00%      | 4.09%                 | 2.73%         | 6.90%   |
| Total     | 1743              | 887         | 448                   | 112           | 3190    |
|           | 54.64%            | 27.81%      | 14.04%                | 3.51%         | 100.00% |

Figura 3. Kënaqshmëria me ujë të pijes



### 3.4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhblokime të kanalizimeve

Të dhënat në tabelë dhe grafikun vijues paraqesin nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e zhblokimit të kanalizimeve nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A., bazuar në 3,190 respondentë.


Në nivel rajonal, 1,591 qytetarë ose 49.87% janë shumë të kënaqur, 950 ose 29.78% të kënaqur, 522 ose 16.36% deri diku të kënaqur dhe 127 ose 3.98% të pakënaqur. Në total, 79.65% e respondentëve e vlerësojnë pozitivisht shërbimin.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e qytetarëve shumë të kënaqur është në Malishevë (57.50%), pasuar nga Prizreni (49.81%) dhe Suhareka (49.15%), ndërsa në Dragash dominon kategoria “i/e kënaqur” me 48.18%. Prizreni përfaqëson edhe pjesën më të madhe të mostrës me 65.83% të totalit. Në të gjitha komunat, niveli i pakënaqshmërisë mbetet i ulët.

Tabela 4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhblokime të kanalizimeve

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1046              | 565         | 390                   | 99            | 2100    |
|           | 49.81%            | 26.90%      | 18.57%                | 4.71%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 231               | 161         | 67                    | 11            | 470     |
|           | 49.15%            | 34.26%      | 14.26%                | 2.34%         | 14.73%  |
| Malishevë | 230               | 118         | 42                    | 10            | 400     |
|           | 57.50%            | 29.50%      | 10.50%                | 2.50%         | 12.54%  |
| Dragash   | 84                | 106         | 23                    | 7             | 220     |
|           | 38.18%            | 48.18%      | 10.45%                | 3.18%         | 6.90%   |
| Total     | 1591              | 950         | 522                   | 127           | 3190    |
|           | 49.87%            | 29.78%      | 16.36%                | 3.98%         | 100.00% |

Figura 4. Kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania në zhblokime të kanalizimeve



### 3.5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit

Matja e kënaqshmërisë me performancën e leximit të ujëmatësve pasqyron perceptimin e konsumatorëve për saktësinë dhe cilësinë e këtij shërbimi. Rezultatet, bazuar në 3,190 respondentë, tregojnë një nivel të lartë vlerësimi pozitiv.


Në nivel rajonal, 1,826 respondentë ose 57.24% janë shumë të kënaqur, 889 ose 27.87% të kënaqur, 399 ose 12.51% deri diku të kënaqur dhe 76 ose 2.38% të pakënaqur. Në total, 85.11% e qytetarëve e vlerësojnë pozitivisht shërbimin e leximit të ujëmatësve.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e respondentëve shumë të kënaqur është në Suharekë (59.36%), pasuar nga Prizreni (57.52%), Malisheva (56.25%) dhe Dragashi (51.82%). Prizreni përfaqëson pjesën më të madhe të mostrës me 65.83% të totalit. Në të gjitha komunat, niveli i pakënaqshmërisë mbetet shumë i ulët.

Tabela 5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1208              | 561         | 274                   | 57            | 2100    |
|           | 57.52%            | 26.71%      | 13.05%                | 2.71%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 279               | 121         | 59                    | 11            | 470     |
|           | 59.36%            | 25.74%      | 12.55%                | 2.34%         | 14.73%  |
| Malishevë | 225               | 134         | 37                    | 4             | 400     |
|           | 56.25%            | 33.50%      | 9.25%                 | 1.00%         | 12.54%  |
| Dragash   | 114               | 73          | 29                    | 4             | 220     |
|           | 51.82%            | 33.18%      | 13.18%                | 1.82%         | 6.90%   |
| Total     | 1826              | 889         | 399                   | 76            | 3190    |
|           | 57.24%            | 27.87%      | 12.51%                | 2.38%         | 100.00% |

Figura 5. Kënaqshmëria me performancën e leximit të ujëmatësve në teren nga lexuesit




### 3.6. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave

Efikasiteti i stafit të K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A. në ofrimin e shërbimeve, përfshirë leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave, përbën një aspekt të rëndësishëm të kënaqshmërisë së konsumatorëve. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e të anketuarve e vlerësojnë pozitivisht këtë dimension të shërbimit, ku 54.01% janë shumë të kënaqur dhe 29.62% të kënaqur. Një pjesë prej 13.86% janë deri diku të kënaqur, ndërsa 2.51% janë të pakënaqur. Në nivel komunal, përqindja më e lartë e qytetarëve shumë të kënaqur është në Malishevë (56.00%), pasuar nga Prizreni (54.38%), Suhareka (52.55%) dhe Dragashi (50.00%). Sa i përket shpërndarjes së mostrës, Prizreni përfaqëson pjesën më të madhe të të anketuarve me 65.83%. Të dhënat janë paraqitur edhe në grafikun përkatës, duke reflektuar një vlerësim përgjithësisht pozitiv për efikasitetin e stafit në të gjitha komunat.

Tabela 6. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1142              | 552         | 342                   | 64            | 2100    |
|           | 54.38%            | 26.29%      | 16.29%                | 3.05%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 247               | 176         | 41                    | 6             | 470     |
|           | 52.55%            | 37.45%      | 8.72%                 | 1.28%         | 14.73%  |
| Malishevë | 224               | 130         | 40                    | 6             | 400     |
|           | 56.00%            | 32.50%      | 10.00%                | 1.50%         | 12.54%  |
| Dragash   | 110               | 87          | 19                    | 4             | 220     |
|           | 50.00%            | 39.55%      | 8.64%                 | 1.82%         | 6.90%   |
| Total     | 1723              | 945         | 442                   | 80            | 3190    |
|           | 54.01%            | 29.62%      | 13.86%                | 2.51%         | 100.00% |

Figura 6. Niveli i kënaqshmërisë me efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve, përgatitjen e faturave, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe pasqyrimin e pagesave



### 3.7. Vlerësimi i mundësive të pagesave së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza

Mundësitë e pagesës që ofron K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A. për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza përbëjnë një element të rëndësishëm në lehtësinë dhe përshtatshmërinë e kryerjes së pagesave nga konsumatorët. Rezultatet e hulumtimit tregojnë një vlerësim pozitiv të përgjithshëm ndaj këtyre alternativave.


Në nivel rajonal, 1,791 respondentë ose 56.14% janë shumë të kënaqur, 905 ose 28.37% të kënaqur, 424 ose 13.29% deri diku të kënaqur dhe 70 ose 2.19% të pakënaqur.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e qytetarëve shumë të kënaqur është në Suharekë (57.87%), pasuar nga Prizreni (56.62%), Malisheva (56.50%) dhe Dragashi (47.27%). Prizreni përfaqëson pjesën më të madhe të mostrës me 65.83% të totalit të respondentëve. Të dhënat tregojnë se shumica e konsumatorëve e vlerësojnë pozitivisht gamën e mundësive të pagesës, përfshirë pagesat në sportele, banka, poste dhe përmes kanaleve elektronike.

Tabela 7. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1189              | 576         | 284                   | 51            | 2100    |
|           | 56.62%            | 27.43%      | 13.52%                | 2.43%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 272               | 141         | 51                    | 6             | 470     |
|           | 57.87%            | 30.00%      | 10.85%                | 1.28%         | 14.73%  |
| Malishevë | 226               | 109         | 59                    | 6             | 400     |
|           | 56.50%            | 27.25%      | 14.75%                | 1.50%         | 12.54%  |
| Dragash   | 104               | 79          | 30                    | 7             | 220     |
|           | 47.27%            | 35.91%      | 13.64%                | 3.18%         | 6.90%   |
| Total     | 1791              | 905         | 424                   | 70            | 3190    |
|           | 56.14%            | 28.37%      | 13.29%                | 2.19%         | 100.00% |

Figura 7. Kënaqshmëria me mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza



### 3.8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara

Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë pasqyron nivelin e kënaqshmërisë me shërbimet si komunikimi telefonik, trajtimi i ankesave dhe pritja nga stafi. Bazuar në 3,190 respondentë, rezultatet tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv.


Në nivel rajonal, 1,621 respondentë ose 50.82% janë shumë të kënaqur, 811 ose 25.42% të kënaqur, 440 ose 13.79% deri diku të kënaqur dhe 173 ose 5.42% të pakënaqur. Ndërkohë, 145 respondentë ose 4.55% kanë deklaruar se nuk kanë kërkuar asnjëherë shërbim nga qendra për konsumatorë.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e qytetarëve shumë të kënaqur është në Suharekë (53.83%), pasuar nga Prizreni (50.95%), Malisheva (50.50%) dhe Dragashi (43.64%). Prizreni përfaqëson pjesën më të madhe të mostrës me 65.83% të totalit. Në përgjithësi, grafiku tregon dominim të përgjigjeve pozitive, ndërsa një pjesë më e vogël e konsumatorëve kanë shprehur pakënaqësi ose nuk kanë pasur kontakt me qendrën për konsumatorë.

Tabela 8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara

| Qytet        | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur   | Nuk kam kërkuar asnjëherë shërbim | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali         |
|--------------|-------------------|---------------|-----------------------------------|-----------------------|---------------|----------------|
| Prizren      | 1070              | 502           | 75                                | 310                   | 143           | 2100           |
|              | 50.95%            | 23.90%        | 3.57%                             | 14.76%                | 6.81%         | 65.83%         |
| Suharekë     | 253               | 121           | 31                                | 53                    | 12            | 470            |
|              | 53.83%            | 25.74%        | 6.60%                             | 11.28%                | 2.55%         | 14.73%         |
| Malishevë    | 202               | 128           | 17                                | 44                    | 9             | 400            |
|              | 50.50%            | 32.00%        | 4.25%                             | 11.00%                | 2.25%         | 12.54%         |
| Dragash      | 96                | 60            | 22                                | 33                    | 9             | 220            |
|              | 43.64%            | 27.27%        | 10.00%                            | 15.00%                | 4.09%         | 6.90%          |
| <b>Total</b> | <b>1621</b>       | <b>811</b>    | <b>145</b>                        | <b>440</b>            | <b>173</b>    | <b>3190</b>    |
|              | <b>50.82%</b>     | <b>25.42%</b> | <b>4.55%</b>                      | <b>13.79%</b>         | <b>5.42%</b>  | <b>100.00%</b> |

Figura 8. Vlerësimi i punës së qendrës për konsumatorë për shërbimet e ofruara



### 3.9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera

Niveli i informimit nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A. për shërbimet teknike, si punimet në terren, ndërprerjet e furnizimit me ujë dhe cilësia e ujit, përbën një element të rëndësishëm në komunikimin me konsumatorët.


Bazuar në 3,190 respondentë, në nivel rajonal 1,797 ose 56.33% janë shumë të kënaqur, 866 ose 27.15% të kënaqur, 467 ose 14.64% deri diku të kënaqur dhe 60 ose 1.88% të pakënaqur. Rezultatet tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv ndaj informimit nga kompania.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e konsumatorëve shumë të kënaqur është në Malishevë (60.50%), pasuar nga Suhareka (59.57%), Prizreni (55.86%) dhe Dragashi (46.36%). Prizreni përfaqëson pjesën më të madhe të mostrës me 65.83% të totalit të respondentëve. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një nivel të lartë kënaqshmërie, me hapësirë të kufizuar për përmirësim në disa zona.

Tabela 9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | I/E kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | I/E pakënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-------------|-----------------------|---------------|---------|
| Prizren   | 1173              | 525         | 351                   | 51            | 2100    |
|           | 55.86%            | 25.00%      | 16.71%                | 2.43%         | 65.83%  |
| Suharekë  | 280               | 139         | 49                    | 2             | 470     |
|           | 59.57%            | 29.57%      | 10.43%                | 0.43%         | 14.73%  |
| Malishevë | 242               | 113         | 43                    | 2             | 400     |
|           | 60.50%            | 28.25%      | 10.75%                | 0.50%         | 12.54%  |
| Dragash   | 102               | 89          | 24                    | 5             | 220     |
|           | 46.36%            | 40.45%      | 10.91%                | 2.27%         | 6.90%   |
| Total     | 1797              | 866         | 467                   | 60            | 3190    |
|           | 56.33%            | 27.15%      | 14.64%                | 1.88%         | 100.00% |

Figura 9. Vlerësimi i nivelit të informimit nga KRU për shërbimet teknike të kryera



### 3.10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Efikasiteti i shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit përbën një tregues të rëndësishëm të performancës së K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. në trajtimin e defekteve dhe ndërhyrjeve teknike.


Bazuar në 3,190 respondentë, në nivel rajonal 1,887 ose 59.15% janë shumë të kënaqur, 928 ose 29.09% deri diku të kënaqur, 293 ose 9.18% pak të kënaqur dhe 82 ose 2.57% të pakënaqur. Rezultatet tregojnë një vlerësim kryesisht pozitiv për këtë shërbim.

Sipas komunave, përqindja më e lartë e konsumatorëve shumë të kënaqur është në Malishevë (69.75%), pasuar nga Suhareka (66.17%), Dragashi (64.09%) dhe Prizreni (55.05%). Prizreni përfaqëson 65.83% të totalit të respondentëve. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një perceptim të mirë për ndërhyrjet teknike dhe mirëmbajtjen e rrjetit, me një përqindje të ulët të pakënaqshmërisë.

Tabela 10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

| Qytet     | Shumë i/e kënaqur | Deri diku i/e kënaqur | Pak i/e kënaqur | I/e pa kënaqur | Totali  |
|-----------|-------------------|-----------------------|-----------------|----------------|---------|
| Prizren   | 1156              | 671                   | 202             | 71             | 2100    |
|           | 55.05%            | 31.95%                | 9.62%           | 3.38%          | 65.83%  |
| Suharekë  | 311               | 121                   | 33              | 5              | 470     |
|           | 66.17%            | 25.74%                | 7.02%           | 1.06%          | 14.73%  |
| Malishevë | 279               | 86                    | 32              | 3              | 400     |
|           | 69.75%            | 21.50%                | 8.00%           | 0.75%          | 12.54%  |
| Dragash   | 141               | 50                    | 26              | 3              | 220     |
|           | 64.09%            | 22.73%                | 11.82%          | 1.36%          | 6.90%   |
| Total     | 1887              | 928                   | 293             | 82             | 3190    |
|           | 59.15%            | 29.09%                | 9.18%           | 2.57%          | 100.00% |

Figura 10. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit



### 3.11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit

Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit përbën një tregues të rëndësishëm të disiplinës financiare të konsumatorëve dhe funksionimit të sistemit të faturimit. Bazuar në 3,190 respondentë, 2,399 ose 75.20% deklarojnë se i paguajnë faturat rregullisht, 772 ose 24.20% kohë pas kohe, ndërsa 19 ose 0.60% kanë deklaruar se nuk i paguajnë asnjëherë.


Sipas komunave, përqindja më e lartë e pagesave të rregullta është në Malishevë (80.00%), pasuar nga Suhareka (79.57%), Prizreni (74.24%) dhe Dragashi (66.36%). Përqindja e atyre që nuk paguajnë asnjëherë mbetet shumë e ulët në të gjitha komunat, me nivel pak më të lartë në Dragash (1.36%) krahasuar me komunat e tjera.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një trend pozitiv sa i përket rregullsisë së pagesave, me shumicën dërrmuese të konsumatorëve që i përmbushin detyrimet e tyre financiare në mënyrë të rregullt.

Tabela 11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit

| Qytet     | Rregullisht | Kohë pas kohe | Asnjëherë | Totali  |
|-----------|-------------|---------------|-----------|---------|
| Prizren   | 1559        | 532           | 9         | 2100    |
|           | 74.24%      | 25.33%        | 0.43%     | 65.83%  |
| Suharekë  | 374         | 93            | 3         | 470     |
|           | 79.57%      | 19.79%        | 0.64%     | 14.73%  |
| Malishevë | 320         | 76            | 4         | 400     |
|           | 80.00%      | 19.00%        | 1.00%     | 12.54%  |
| Dragash   | 146         | 71            | 3         | 220     |
|           | 66.36%      | 32.27%        | 1.36%     | 6.90%   |
| Total     | 2399        | 772           | 19        | 3190    |
|           | 75.20%      | 24.20%        | 0.60%     | 100.00% |

Figura 11. Rregullsia e pagesës së faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit



### 3.12. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit


Arsyet për mospagesën e rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit lidhen kryesisht me gjendjen ekonomike të konsumatorëve, ndërsa pakënaqësia me shërbimin përbën një pjesë shumë më të vogël të rasteve. Nga 3,190 respondentë, 728 ose 22.82% e kanë përmendur gjendjen ekonomike si arsye, ndërsa 63 ose 1.97% pakënaqësinë me shërbimin e pranuar. Ndërkohë, 2,399 ose 75.20% kanë deklaruar se paguajnë me rregull faturat.

Sipas komunave, në Prizren 23.57% e lidhin mospagesën me gjendjen ekonomike dhe 2.19% me pakënaqësinë ndaj shërbimit. Në Suharekë, 19.36% përmendin gjendjen ekonomike dhe 1.06% pakënaqësinë. Në Malishevë, 18.00% e lidhin me situatën financiare dhe 2.00% me cilësinë e shërbimit. Ndërsa në Dragash, 31.82% e konsiderojnë gjendjen ekonomike si arsye dhe 1.82% pakënaqësinë me shërbimin. Të dhënat tregojnë se faktori ekonomik mbetet arsyeja kryesore që ndikon në vonesat apo mospagesat, ndërsa pakënaqësia me shërbimin paraqet një përqindje të ulët në të gjitha komunat.

Tabela 12. Arsyet e mospagesës së rregullt të faturave të ujësjellësit dhe kanalizimit

